



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 1376 prot.

Gjirokastrë, më 18.09. 2025

APROVOI
REKTORI

Prof. dr. Jahor Cana



Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Universitetin e Janinës, Greqi.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti i Janinës hap thirrjen për shkëmbim studentësh me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes Ndërinstitucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me 1 (një) student, për periudhën tetor - shkurt 2026. Thirrja është e hapur për studentët e ciklit të parë të studimit (Bachelor), viti i dytë dhe i tretë, dhe ciklit të dytë (Master), viti i dytë, të Njesisë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek. Gjuha e përdorur do të jetë greqisht, minimalisht në nivelin B1.

Të interesuarit të dërgojnë pranë Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **23.09.2025**, në formë fizike dhe elektronike:

- Vërtetim studenti;
- Listë notash;
- Letër Interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS, në anglisht;
- Provë / certifikatë të njohurive të gjuhës greke, minimalisht të nivelit B1;
- Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision *ad hoc* i ngritur pranë UGJ-së dhe më pas, Sektori i Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor do t'i përcjellë nominimet universitetit partner për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Zv/Rektore për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj